

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-26-2448-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EKOLOGJIA SH.P.K.
NUI	811320168
Adresa	Cen Dugolli
Vendi	FERIZAJ
Kodi postar	70000
Numri Telefonit	044121173
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ramadan Gashi
Adresa elektronike	ekologjia@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	22.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare

Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per Rishqyrtim13.06.2026 11:16

Vendimi i kërkesës për rishqyrtim 2448.docx16.06.2026 13:57

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve26.05.2026 14:02

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per Rishqyrtim13.06.2026 11:16

Vendimi i kërkesës për rishqyrtim 2448.docx16.06.2026 13:57

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së - Qellimi i Ligjit

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 59.4 i LPP-së - pasi kapaciteti 700L i pajisjeve të ofruara nga GOE EKOLOGJIA SH.P.K. dhe DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K. është trajtuar si mospërmbushje të kriterit, pa u analizuar nëse bëhet fjalë për një devijim që nuk ndryshon karakteristikat materiale të kërkesës.

Neni 108/A i LPP-së - AK nuk e ka trajtuar fare pretendimet ankimore, ka bërë vetëm perseritje të arsyetimit për eliminim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI NR. 1

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se në vend të dy (2) Power Sprayer me kapacitet 500L kemi ofruar dy pajisje me kapacitet 700L.

Ky vlerësim është i gabuar dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, pasi pajisjet e ofruara nga ne jo vetëm që plotësojnë funksionin e kërkuar, por posedojnë kapacitet më të madh teknik dhe operacional se minimumi i kërkuar nga Dosja e Tenderit.

Neni 59 i LPP-së përcakton:

"Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse përmban vetëm devijime të vogla që nuk shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Në rastin konkret, kapaciteti 700L nuk ndryshon funksionin apo performancën e pajisjes, por paraqet kapacitet më të madh se minimumi i kërkuar.

AK nuk ka dhënë asnjë analizë teknike apo profesionale se si kapaciteti 700L e pamundëson realizimin e kontratës apo e bën pajisjen të papërshtatshme.

Për më tepër, vetë AK ka pranuar se arsyeja e vetme e eliminimit është dallimi në kapacitet, pa analizuar natyrën e këtij devijimi dhe pa zbatuar dispozitat e nenit 59.4 të LPP-së.

PRETENDIMI NR. 2

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar:

c) Dy (2) Power Sprayer (Spërkatëse motorike) me kapacitet 500L

si dhe:

"Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet të dëshmohet me kontratë për këtë projekt."

Pas qasjes në dokumentacionin zyrtar është konstatuar se GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I. ka paraqitur marrëveshje me kompaninë Tafaj & Co SH.P.K.

Megjithatë, në këtë marrëveshje përmendet vetëm një pajisje "Atomizer Profesional 600L", ndërsa mungon plotësisht pajisja e dytë e kërkuar.

Prandaj, GOE në fjalë nuk ka dëshmuar posedimin apo shfrytëzimin e dy pajisjeve të kërkuara, siç kërkohet shprehimisht nga Dosja e Tenderit.

Përkundër kësaj mungese substanciale, AK nuk ka bërë asnjë analizë dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim në vendimin e tij.

PRETENDIMI NR. 3

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se pajisjet e ofruara nga GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I. janë Atomizer profesionalë të përdorur kryesisht në sektorin e bujqësisë për trajtimin e pemishteve dhe kulturave bujqësore.

Këto pajisje nuk janë identifikuar si Power Sprayer sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Përkundër kësaj, AK i ka konsideruar si të pranueshme pa asnjë analizë profesionale, ndërsa ofertën tonë e ka eliminuar për shkak të kapacitetit 700L.

Ky trajtim i ndryshëm për raste të ngjashme përbën shkelje të parimit të barazisë në trajtim.

PRETENDIMI NR. 4

Dosja e Tenderit ka kërkuar:

"Të ketë së paku 5 punëtorë të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizimin e kontratës."

Pas qasjes në dokumentacionin zyrtar të ofertës së GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I., rezulton se janë paraqitur këto profile:

- Epidemiolog;
- Bachelor i Shkencave të Mjekësisë Sanitare;
- Teknik Sanitar;
- Inxhinier i Bujqësisë;

ndërsa katër persona të tjerë figurojnë vetëm si:

"Teknik DDD"

Përcaktimi "Teknik DDD" nuk përfaqëson profil profesional të veçantë, pasi nuk tregon profesionin, kualifikimin apo fushën akademike të personit.

Në mungesë të dëshmive mbi profilet profesionale të këtyre personave, kërkesa për pesë profile të ndryshme profesionale nuk mund të konsiderohet e përmbushur.

PRETENDIMI NR. 5

Në vendimin e datës 16.06.2026 AK nuk ka trajtuar fare:

pretendimin për mungesën e pajisjes së dytë, pretendimin se pajisjet nuk janë Power Sprayer, pretendimin për mungesën e pesë profileve profesionale, pretendimet për trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

AK është kufizuar vetëm në përsëritjen e arsyes së eliminimit tonë.

Për rrjedhojë, vendimi nuk përbën shqyrtim të kërkesës për rishqyrtim.

KËRKESAT TONA

1. Të aprovohet ankesa si e bazuar.
2. Të anulohet vendimi i AK-së i datës 16.06.2026.
3. Të anulohet vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
4. Të konstatohet se eliminimi i GOE EKOLOGJIA SH.P.K. & DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K. është bërë në kundërshtim me LPP-në.
5. Të konstatohet se kapaciteti 700L nuk përbën devijim material sipas nenit 59.4 të LPP-së.
6. Të konstatohet se GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I. nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës për dy (2) Power Sprayer.
7. Të konstatohet se GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I. nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës për pesë profile të ndryshme profesionale.
8. Të eliminohet oferta e GOE Vector Pest Control SH.P.K. & Jusuf Berisha B.I. si ofertë e papërgjegjshme.
9. Të urdhërohet rivlerësimi i ofertave.
10. Pas rivlerësimit, të shpallet fitues GOE EKOLOGJIA SH.P.K. & DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e mundësisë për fitimin e kontratës publike

Humbja e fitimit të pritshëm

Shpenzimet e përgatitjes së ofertës

Dëmi ekonomik i shkaktuar nga anulimi i padrejtë i procedurës

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*